



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



RAPORT VJETOR

MBI VLERËSIMIN E PËRMBUSHJES SË CAQEVE TË PËRCAKTUARA PËR VITIN 2013 ME PROCESIN RREGULLATOR TË TARIFAVE 2012-2014

ANALIZA:

vjetore 2013

Periudha raportuese: Janar – Dhjetor 2013

DFTRR/ZRRUK

Prishtinë, 31 Korrik 2014

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçiente të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

Misioni

“Rregullimi efektiv, transparent i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë shërbime kuantitative dhe kualitative, të qëndrueshme me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.”

PËRMBAJTA

1	HYRJE	5
2	SFIDIMI I BIZNES PLANEVE RREGULLATORE	6
3	APLIKIMI I INFLACIONIT	7
4	METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE.....	8
5.	ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËT	9
5.1	Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m ³ dhe numrit të konsumatorëve.....	10
6.	ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE.....	12
6. 1	Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza	13
6.2	Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza	14
7.	SHUMAT E Faturimit dhe arkëtimi në vlerë monetare	16
7.1.	Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza.....	17
7.2	Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza	18
7.3.	Shuma e arkëtitimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza	19
7.4.	Paraqitja grafike e arkëtitimit për ujë dhe ujëra të zeza	20
8.	INVESTIMET KAPITALE	21
8.1.	Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake.....	22
8.2.	Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive	25
8.3.	Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët	26
8.4.	Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët	29
8.5.	Investimet në përtëritjen e infrastrukturës.....	30
9.	KONKLuzionET E RAPORTIT	32
10.	RANGIMI I KRU-VE SIPAS REALIZIMIT TË CAQEVE	33
11.	Komentet e KRU "Prishtina" sh. a. Prishtinë dhe përgjigja e DFTRR, ZRRUK për të njëjtën	38

Akronimet dhe shkurtesat

BPRR	Biznes Plane Rregullatore
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
FE	Kompania Rajonale e Ujit “Bifurkacioni” sh.a –Ferizaj
GJA	Kompania Rajonale e Ujit “Radoniqi” sh.a – Gjakovë
GJI	Kompania Rajonale e Ujit “Hidromorava” sh.a – Gjilan
MIT	Kompania Rajonale e Ujit “Mitrovica” sh.a – Mitrovicë
PE	Kompania Rajonale e Ujit “Hidrodrini” sh.a – Pejë
PR	Kompania Rajonale e Ujit “Prishtina” sh.a – Prishtinë
PZ	Kompania Rajonale e Ujit “Hidroregjioni-Jugor” sh.a – Prizren
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
BARRA	Baza Rregullatore e Aseteve

1 HYRJE

Ky raport pasqyron të dhënat e performancës së shtatë (7) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza, me të cilën vlerësohet përmbushja e caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të tarifave gjatë vitit 2013 dhe jep një pasqyrë të përgjithshme të sektorit për periudhën e shikuar.

Për t'u përpiluar ky raport, fillimisht janë marrë të dhënat e aprovuara nga procesi tarifor 2012-2014, për vitin 2013, të cilat njëkohësisht paraqesin të dhënat bazë përmes të cilave vlerësohet afarizmi i të gjitha KRU-ve në Kosovë. Më pastaj, janë paraqitur të dhënat e realizuara nga KRU-të për vitin 2013 për krahasim me të dhënat e aprovuara nga ZRRUK. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të zhvillimeve në sektor, në këtë raport janë paraqitur edhe të dhënat historike të cilat kanë ndodhur gjatë vitit 2012.

Qëllimi i këtij raporti është:

- (i) Të jepet informacion për trendin e treguesve operativ dhe financiar të KRU-ve dhe në veçanti për shkallën e investimeve kapitale të realizuara për përdhën e shikuar kohore.
- (i) Të krahasohen treguesit e KRU-ve me objektivat (caqet) e përcaktuara të procesit tariforë të periudhës së shikuar dhe në rast të shmangieve t'u mundësohet KRU-ve të ndërmarrin veprime të duhura me kohë për të ndryshuar, ose korrigjuar trendët e tilla gjatë vitit të fundit të procesit tarifor 2014 nga procesi rregullatorë 2012-2014.

Duke pasur parasysh që KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë, vepron në kushte të veçanta të operimit, pasi që i ofron ujë të trajtuar me shumicë për pjesën Veriore të këtij qyteti, të dhënat e kësaj kompanie pasqyrohen për gjithë regjionin me të gjitha shërbimet që i ofron kjo kompani, duke i përfshi edhe shërbimet e furnizimit me ujë të trajtuar me shumicë të pjesës Veriore të Qytetit të tyre.

2 SFIDIMI I BIZNES PLANEVE RREGULLATORE

Edhe pse në raportin përmbyllës tarifar 2012-2014 është përshkruar në detaje mënyra se si ZRRUK ka sfiduar BPRR-t e kompanive gjatë procesit të përcaktimit të tarifave, kemi konsideruar të arsyeshme që edhe në këtë raport të bëjmë një përshkrim të shkurtër se si ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të të jenë më eficientë në shërbimet e tyre ndaj konsumatorëve.

Parimi bazë i procesit rregullatorë ka qenë qëndrueshmëria financiare për kompanitë që nënkupton shërbime më të mira për konsumatorët e shërbyer, të cilat shpresojmë se arrihen me tarifa të arsyeshme të cilat janë të përballueshme për t'u paguar nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve të shërbyer, sikurse që kemi përcaktuar edhe caqe sfiduese për përmirësim të performancës së përgjithshme të tyre, dhe atë:

1. ZRRUK mendon se shpenzimet operative janë shumë më të larta se sa ato do të duhej të ishin, dhe roli i tyre ngritët pasi që kanë ndikim të drejtpërdrejt në tarifa. Gjatë diskutimeve tona me disa nga përfaqësuesit e kompanive kemi kërkuar nga ta që kostot e tyre të larta t'i për afrojnë me kostot mesatare të sektorit.
2. Ne besojmë se KRU-të kanë një shkallë të lartë të humbjeve komerciale, shumë kyçje të pa ligjshme dhe faturim jo të kënaqshëm, të cilat duhet të jenë në fokus të menaxhmenteve për t'i minimizuar ato, ose sjellë në relacione optimale.
3. Edhe pse performanca në arkëtimin e të ardhurave është duke u përmirësuar, vendosmërisht jemi të mendimit se përmirësimet janë shumë të ulëta në krahasim me atë se sa ato do duhej të ishin, edhe pse ne kemi qenë të kujdesshëm për të mos qenë shumë ambicioz tek këta tregues themelorë për procesin rregullatorë 2012-2014.

Prandaj, ZRRUK do të kryej monitorimin e rregullt për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara me procesin aktual rregullator (siç po bëjmë edhe me këtë raport).

3 APLIKIMI I INFLACIONIT

Përderisa qëllimi i këtij raporti kryesisht ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2012-2014, për vitin 2013, dhe për të qenë vlerësimi në të sa më real, të dhënat financiare të aprovuara nga ZRRUK të paraqitura në tabelat e mëposhtme janë të përshtatura me Indeksin e Çmimeve të Konsumit në Kosovë publikuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës të periudhës vlerësuese.

Duhet theksuar se, të dhënat financiare të aprovuara për vitin 2013 kanë marrë për bazë çmimet e mesit të vitit 2011 (Qershor 2011 = kur IÇKK-ja ishte 121.4), ngase BPRR për procesin tarifor 2012-2014 janë dorëzuara gjatë asaj kohe.

Për këtë, të dhënat financiare të aprovuara nga ZRRUK ndryshojnë prej të dhënave financiare që gjenden në BPRR, tek secila KRU.

Të dhënat financiare të aprovuara, në këtë raport, kanë marrë për bazë të dhënat e BPRR-ve duke i shumëzuar me IÇKK 1.04695. Ky indeks është fituar duke pjesëtuar mesataren e IÇKK të vitit 2013 (127.10) me IÇKK mesit e vitit 2011 (121.4).

Sikurse edhe u theksua më lartë qëllimi i këtij raporti ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2012-2014 për vitin 2013.

4 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

Metodologjia e vlerësimit të përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2012-2014 për vitin 2013, do të jetë uniforme për të gjitha kategoritë e të dhënave të realizuara nga KRU-të për periudhën e shikuar kohore.

Kjo metodologji do të pasqyrohet në tabela përkatëse për të gjitha kategoritë e të dhënave, sikurse në vijim:

- të dhënat historike të realizuara nga KRU gjatë vitit 2012,
- të dhënat e aprovuara nga ZRRUK për vitin 2013,
- të dhënat e realizuara nga KRU gjatë vitit 2013,
- përqindja krahasuese e vitit 2013 me atë të vitit 2012,
- përqindja e realizimit të caktuar për vitin 2013, dhe
- vlerësimi përfundimtar.

Përqindja krahasuese e vitit 2013 me periudhën e njëjtë kohore të vitit 2012 është raporti i të dhënave të dala nga treguesit e arritur të periudhave të shikuara dhe të shumëzuar me 100.

Përqindja e realizimit të caktuar për vitin 2013 del si rezultat i raportit të dhënave të përcaktuara si cak për çdo kompani veç e veç dhe sektorit në përgjithësi me të dhënat e realizuara nga KRU-të dhe të shumëzuar me 100.

Vlerësimi përfundimtar për vitin 2013 i paraqitur në kolonën e fundit është vlerësim i rregullatorit, dhe identifikohet si:

Shkurtesa	Përshkrimi	Vlerësimi
R	E realizuar	Pozitiv
Jo e R	Jo e realizuar	Negativ
T P	Tejkaluar pozitivisht	Pozitiv
T N	Tejkaluar negativisht	Negativ
E pa K	E pa krahasueshme	Pa të dhëna krahasuese

5. ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËT




Analiza në vazhdim ofron të dhëna për këto kategori operative të shërbimeve të ujit të shprehura në metër kub (m³): (I) uji i prodhuar, (II) uji i humbur apo i pa faturuar, (III) uji i faturuar, (iv) dhe numrin e konsumatorëve.



Tabela Nr. 1. Pasqyra e të dhënave sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar dhe numrin e konsumatorëve shërbyer gjatë vitit 2012 e krahasuar me të dhënat e vitit 2013, caqet e përcaktuara dhe aprovuara për vitin 2013 me % krahasuese 2013/2012 dhe 2013 me vlerësimin e ZRRUK-ut

Emri i Kompanisë	Të dhënat operative	Njësia	Historike 2012	Aprovuara 2013	Realizuara nga KRU-të 2013	% krahasuese 2013/ 2012	% e real. të caktut 2013	Vlerësimi për vitin 2013
Prishtina (PR)	Uji i prodhuar	m ³	45,054,046	44,465,000	41,245,897	91.55%	92.76%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	24,094,986	19,554,042	20,812,306	86.38%	106.43%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	20,959,060	24,910,958	20,433,591	97.49%	82.03%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	94,917	105,418	100,572	105.96%	95.40%	Jo e R
Hidroregjioni Jugor (PZ)	Uji i prodhuar	m ³	19,673,736	20,367,487	19,273,615	97.97%	94.63%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	11,998,622	12,523,638	11,524,935	96.05%	92.03%	R
	Uji i faturuar	m ³	7,675,114	7,843,849	7,748,680	100.96%	98.79%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	36,226	34,140	38,878	107.32%	113.88%	R
Hidrodrini (PE)	Uji i prodhuar	m ³	26,981,112	28,683,294	28,437,516	105.40%	99.14%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	17,908,203	19,523,204	20,366,510	113.73%	104.32%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	9,072,909	9,160,090	8,071,006	88.96%	88.11%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	32,534	33,059	38,106	117.13%	115.27%	R
Mitrovica (MIT)	Uji i prodhuar	m ³	17,610,092	18,640,000	16,890,010	95.91%	90.61%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	9,117,685	8,945,609	8,412,659	92.27%	94.04%	R
	Uji i faturuar	m ³	8,492,407	9,694,391	8,477,351	99.82%	87.45%	Jo e R
	Faturimi-Jug	m ³	4,507,452	5,194,391	4,158,598	92.26%	80.06%	Jo e R
	Faturimi-Veri	m ³	3,984,955	4,500,000	4,318,753	108.38%	95.97%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	22,815	23,966	23,723	103.98%	98.99%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Uji i prodhuar	m ³	15,073,168	20,508,988	14,776,626	98.03%	72.05%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	8,877,219	13,957,011	7,596,404	85.57%	54.43%	R
	Uji i faturuar	m ³	6,195,949	6,551,977	7,180,222	115.89%	109.59%	R
	Konsumatorët	Nr	28,703	29,406	29,210	101.77%	99.33%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Uji i prodhuar	m ³	6,109,204	6,456,237	6,105,506	99.94%	94.57%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	3,572,431	2,996,268	3,376,993	94.53%	112.71%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	2,536,773	3,459,969	2,728,513	107.56%	78.86%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	15,905	18,878	17,150	107.83%	90.85%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Uji i prodhuar	m ³	7,610,126	7,227,539	7,730,074	101.58%	106.95%	R
	Uji i humbur	m ³	4,640,044	3,804,610	4,288,148	92.42%	112.71%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	2,970,082	3,422,929	3,441,926	115.89%	100.55%	R
	Konsumatorët	Nr	20,106	19,806	23,151	115.14%	116.89%	R
SEKTORI	Uji i prodhuar	m ³	138,111,48	146,348,54	134,459,24	97.36%	91.88%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	80,209,190	81,304,382	76,377,955	95.22%	93.94%	R
	Uji i faturuar	m ³	57,902,294	65,044,163	58,081,289	100.31%	89.30%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	251,206	264,673	270,790	107.80%	102.31%	R

5.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m³ dhe numrit të konsumatorëve

Të dhënat e tabelës Nr. 1. janë paraqitur grafikisht përmes grafikoneve të cilat mundësojnë krahasimin më vizual të të dhënave historike të vitit 2012 me të dhënat e aprovuara nga ZRRUK dhe të dhënave të realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2013.





Gjendja e sektorit të ujit në Kosovë mund të paraqitet duke shfrytëzuar **Diagramin Merimangë**. Përpos tek të dhënat operative, ky diagram do të shfrytëzohet edhe tek kategoritë tjera të të dhënave në këtë raport.

Septagrami (lakorja) me ngjyrë të kuqe (shtatë këndesh) paraqet sasinë e ujit të prodhuar nga të gjitha KRU-të në Kosovë shprehur në përqindje. Hapësira e kaltër tregon sa përqind e ujit të prodhuar faturohet. Ndërkaq, hapësira me ngjyrë të gjelbër paraqet në përqindje se sa prej ujit të prodhuar arkëtohet.

Prej këtu mund të kuptojmë se diferenca në mes të septagramit (lakores ngjyrë kuqe) dhe hapësirës me ngjyrë të kaltër paraqet ujin e humbur për çdo kompani veç e veç dhe për sektor, kurse diferenca në mes të hapësirës së kaltër dhe hapësirës së gjelbër paraqet llogaritë e arkëtueshme–borxhet e konsumatorëve ndaj kompanive për periudhën e shikuar të vitit 2013.

Për të qenë KRU-të në gjendje të mirë financiare dhe me nivele të kënaqshme të shërbimit për konsumatorët e tyre, kompanitë duhet të ngrisin performancën e tyre në krahasim me atë që është.

6. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Sikurse u cek edhe më lartë, gjatë procesit tarifer 2012-2014, ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të të jenë më të kujdesshëm me shpenzimet e tyre të drejtpërdrejta operative dhe ka kërkuar që të njëjtat të ulen deri në optimumin e arsyeshëm.

Për të qenë më konsekuent në aprovimin e shpenzimeve operative të cilat kanë ndikim direkt në lartësinë e tarifës, ne kemi përdorur metodën e regresionit për ato kompani që kanë pasur shpenzime operative mbi kostot optimale mesatare të disa kompanive të vlerësuara si shpenzime të arsyeshme dhe për këtë arsye kemi konsideruar se kjo është metoda më e arsyeshme dhe më transparente për reduktimin e shpenzimeve operative të KRU-ve të cilat konsiderohen me shpenzime jo shumë racionale.

Të dhënat e shpenzimeve operative të paraqitura në këtë raport janë kategorizuar konform udhëzimeve të kontabilitetit rregullator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe kanalizim.

Sipas UKRR, shpenzimet operative për ujë i kemi paraqitur të ndara në tri kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim-shpërndarje, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të zeza, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Për detaje më të hollësishme se cilat zëra të shpenzimeve operative futen në kategoritë përkatëse, mund të konsultoheni me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, i cili gjendet i publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRUK (www.wwro-ks.org).


6.1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza

Në këtë tabelë janë të paraqitura shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza për secilën KRU dhe sektorin, duke paraqitur shpenzimet operative historike të vitit 2012, ato të aprovuara nga ZRRUK si dhe ato të realizuara nga KRU gjatë vitit 2013, shkallën e përmbushjes së caqeve në % dhe vlerësimi përfundimtar për këtë periudhë kohore.



Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza në €


Emri i Kompanisë	Zërat e shpenzimeve operative	Njësia	Historike 2012	Aprovuara nga ZRRUK 2013	Realizuara nga KRU 2013	% krahasues e 2013/2012	% e real. të cakt. 2013	Vlerësimi përfundimtar për vitin 2013
Prishtina (PR)	Ujë	€	7,805,924	5,625,024	7,849,837	100.56%	139.55%	TN
	Ujëra të Zeza	€	248,855	207,188	260,658	104.74%	125.81%	TN
	Totali	€	8,054,779	5,832,212	8,110,495	100.69%	139.06%	TN
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	2,634,194	2,433,095	2,869,790	108.94%	117.95%	TN
	Ujëra të Zeza	€	135,687	137,373	146,652	108.08%	106.75%	TN
	Totali	€	2,769,882	2,570,468	3,016,442	108.90%	117.35%	TN
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,545,594	1,612,534	1,633,331	105.68%	101.29%	TN
	Ujëra të Zeza	€	88,679	87,739	90,061	101.56%	102.65%	TN
	Totali	€	1,634,273	1,700,273	1,723,392	105.45%	101.36%	TN
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	1,871,313	1,638,485	1,852,035	98.97%	113.03%	TN
	Ujëra të Zeza	€	197,772	163,128	186,719	94.41%	114.46%	TN
	Totali	€	2,069,085	1,801,613	2,038,754	98.53%	113.16%	TN
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,963,927	1,617,455	2,202,941	112.17%	136.20%	TN
	Ujëra të Zeza	€	143,474	84,072	175,315	122.19%	208.53%	TN
	Totali	€	2,107,401	1,701,527	2,378,256	112.85%	139.77%	TN
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	731,433	753,941	807,981	110.47%	107.17%	TN
	Ujëra të Zeza	€	56,237	55,829	88,148	156.74%	157.89%	TN
	Totali	€	787,670	809,770	896,129	113.77%	110.66%	TN
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	1,111,096	936,066	1,119,193	100.73%	119.56%	TN
	Ujëra të Zeza	€	109,468	79,288	101,863	93.05%	128.47%	TN
	Totali	€	1,220,564	1,015,354	1,221,056	100.04%	120.26%	TN
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	17,663,481	14,616,600	18,335,108	103.80%	125.44%	TN
	Ujëra të Zeza	€	980,173	814,617	1,049,415	107.06%	128.82%	TN
Totali i përgjithshëm sektorial		€	18,643,654	15,431,218	19,384,524	103.97%	125.62%	TN

Nga totali i shpenzimeve operative që kanë ndodhur gjatë vitit 2013, 94.59% të shpenzimeve kanë ndodhur në shërbimin e ujit, ndërsa 5.41% janë shpenzime të ujërave të zeza. Totali i shumës së shpenzimeve operative të realizuara për të dy shërbimet nga KRU-të gjatë vitit 2013 është 19,384,524 €, të cilat si të tilla janë tejkaluar nga shuma e aprovuar nga ZRRUK për këtë periudhë në lartësi prej 25.62%.



6.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza





Prej grafikorit merimangë shihet se nga shuma e shpenzimeve të aprovuar për periudhën e shikuar të vitit 2013, asnjëra prej KRU-ve nuk ka arritur t'i ketë brenda limiteve të përcaktuara nga Rregullatori të njëjtat. Vlen të theksohet përkushtimi i KRU "Hidrodrini" e cila ka arritur të menaxhoje mirë me shpenzimet e aprovuara nga ZRRUK për vitin 2013.

Është e ditur se kostoja e pagave për të punësuarit në të gjitha KRU-të paraqesin zërat më të larta të tyre dhe për t'i pasqyruar të njëjtat në raport me kostot tjera po i paraqesim në Tabelën e më poshtme, prej nga mund të kuptojmë lehtë se cila kompani menaxhon më mirë me zërin e pagave. Pos tjerash në këtë tabelë do të paraqitet edhe paga mesatare për secilën kompani.

Tabela Nr. 3 Shpenzimet e pagave në raport me shpenzimet totale dhe paga mesatare për vitin 2013

Emri i Kompanisë	Totali i shpenzimeve operative të realizuara	Totali i shpenzimeve të pagave të realizuara	Numri i të punësuarve	Përqindja e pagave në raport me shpenzimet e realizuara	Paga mesatare mujore
	€	€	Nr	%	€/muaj
PRISHTINA	8,120,495	4,288,240	538	53%	664
HIDROREGJIONI-JUGOR	3,016,442	1,628,972	295	54%	460
HIDRODRINI	1,723,392	1,011,419	216	59%	390
MITROVICA	2,038,754	1,124,054	222	55%	422
RADONIQI	2,378,256	1,665,501	240	70%	578
BIFURKACIONI	896,129	585,366	119	65%	410
HIDROMORAVA	1,221,055	749,382	150	61%	416
SEKTORI	19,394,524	11,052,934	1,780	57%	517

7. SHUMAT E FATURIMIT DHE ARKËTIMI NË VLERË MONETARE

Të dhënat për faturim dhe arkëtim në vlerë monetare do të paraqiten po ashtu në formë tabelore, për krahasim më të lehtë të rezultateve të arritura nga kompanitë dhe sektori gjatë vitit 2013 me ato të aprovuara nga ZRRUK për të njëjtën periudhë kohore, sipas procesit rregullatorë të përcaktimit të tarifave të viteve 2012-2014.

Edhe këto të dhëna do të paraqiten sipas shërbimeve të ofruara; veç për shërbimet e ujit dhe veç për shërbimet e kanalizimit dhe pastaj të përmbledhura do të paraqiten për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi përgjatë periudhës së shikuar të vitit 2013 dhe për krahasime do të pasqyrohen edhe të dhënat e realizuara gjatë vitit 2013 me të dhënat historike për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2012.

Sipas politikave tarifore, të cilat janë publikuar nga ZRRUK në Mars të vitit 2011, faturimi dhe arkëtimi nga tarifa fikse dhe volumetike i atribuohet shërbimeve të ujësjellësit, ndërsa tarifa volumetrike për kanalizim i atribuohet si e vetme shërbimeve të ujërave të zeza.

Duke pasur parasysh se jo të gjitha KRU-të kanë qenë në gjendje të bëjnë ndarjen e arkëtimit për ujë dhe ato për ujëra të zeza, ZRRUK ka qenë i detyruar që të bëjë këtë ndarje sipas një gjykimi i cili është konsideruar si më i arsyeshmi, për kushtet në të cilat gjendemi. Kjo ndarje është bazuar në faturimin e planifikuar sipas BPRR të aprovuar nga ZRRUK dhe ato të realizuara nga KRU-të dhe sektorit të cilit i takojnë.

Shënim:

Duhet theksuar se për KRU "Mitrovica" sh. a – Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete nga Buxheti i Republikës së Kosovës çdo vit, që nga pas lufta, për të mbuluar një shumë të caktuar të shpenzimeve operative të cilat krijohen me rastin e furnizimit me ujë të pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës. Në mënyrë që vlerësimi i ZRRUK-ut të jetë real, të dhënat e më poshtme i atribuohen të dy zonave të shërbimit (Jugore dhe Veriore), dhe si të tilla do të identifikohen aty ku është e mundur (faturimi e arkëtimi) për periudhat e shikuara.


7.1. Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur faturimi i shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të vitit 2012, ato të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga KRU-të dhe sektori gjatë vitit 2013.

Tabela Nr. 4 Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujërave të zeza në vlerë monetare




Emri i Kompanisë	Të dhënat e faturimit për:	Njësia	Historike 2012	Aprovuara nga ZRRUK 2013	Realizuara nga KRU 2013	% krahasuese 2013/2012	% e real. të caktut 2013	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	11,433,046	14,699,560	11,414,936	99.84%	77.65%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	1,089,881	1,417,029	1,115,722	102.37%	78.74%	Jo e R
	Totali	€	12,522,927	16,116,589	12,530,658	100.06%	77.75%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	3,369,434	4,226,233	3,799,758	112.77%	89.91%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	390,817	463,489	395,983	101.32%	85.44%	Jo e R
	Totali	€	3,760,251	4,689,722	4,195,741	111.58%	89.47%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	2,700,965	3,314,568	2,672,060	98.93%	80.62%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	318,463	417,337	257,717	80.93%	61.75%	Jo e R
	Totali	€	3,019,428	3,731,905	2,929,777	97.03%	78.51%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë-Jugu	€	2,004,135	2,580,772	1,974,265	98.51%	76.50%	Jo e R
	Ujë-Veriu	€	637,593	765,000	734,188	115.15%	95.97%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	344,389	580,600	404,225	117.37%	69.62%	Jo e R
	Totali¹	€	2,348,524	3,161,372	2,378,490	101.28%	75.24%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	2,760,849	3,238,961	3,132,119	113.45%	96.70%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	302,691	437,408	390,391	128.97%	89.25%	Jo e R
	Totali	€	2,348,524	3,161,372	3,522,510	114.98%	95.81%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	1,140,422	1,578,276	1,299,739	113.97%	82.35%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	219,505	457,185	238,714	108.75%	52.21%	Jo e R
	Totali	€	1,359,927	2,035,461	1,538,453	113.13%	75.58%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	1,345,807	1,678,095	1,487,892	110.56%	88.67%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	249,604	361,541	284,821	114.11%	78.78%	Jo e R
	Totali	€	1,595,411	2,039,636	1,772,713	111.11%	86.91%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	24,754,659	31,316,466	25,780,769	101.53%	82.32%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	2,915,350	4,899,588	3,087,573	105.91%	63.02%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial	€	27,670,009	36,216,054	28,868,342	101.98%	79.71%	Jo e R	

Është e rëndësishme të theksohet se në sektorin e ujit në Kosovë, 89.30 % të shumës së faturimit realizohet nga shërbimi i ujit, ndërsa 10.70% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total për sektorin, gjatë vitit 2013 është realizuar faturimi në vlerë prej 28,868,342€, e që paraqet 79.71% të shumës së aprovuar nga procesi rregullatorë për vitin 2013.



¹ Në këtë pikë, totali nuk përmban edhe sasinë e faturimit për pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës. Por, për të qenë të informuar palët e interesit për sasinë e ujit të faturara për atë pjesë, ne e kemi vendosur vetëm si shifër ilustrative.

7.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza



Nga grafikoni merimangë vërehet se asnjëra KRU nuk ka arritur të realizoj faturimin në Euro ashtu siç është aprovuar nga ZRRUK në procesin tarifor 2012-2014, për vitin 2013. Si rezultat i kësaj kemi edhe të dhënat sektoriale për këta tregues.

Vlen të theksohet se KRU "Radoniqi" i është afruar më së shumti këtij caku, dhe atë në vlerë prej 95.81%.


7.3. Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur arkëtimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të vitit 2012, ato të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2013 të cilat si të tilla krahasohen dhe vlerësohen sipas pasqyrës së mëposhtme.

Tabela Nr. 5 Shumat e arkëtimit për shërbimet e ujit në vlerë monetare




Emri i Kompanisë	Faturimi për shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 2012	Aprovuara nga ZRRUK 2013	Realizuara nga KRU 2013	% krahasuese 2013/2012	% e real. të caktut 2013	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	8,574,751	11,159,387	8,689,495	101.34%	77.87%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	816,306	1,106,675	849,331	104.05%	76.75%	Jo e R
	Totali	€	9,391,057	12,266,063	9,538,826	101.57%	77.77%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	2,414,373	3,169,727	2,745,421	113.71%	86.61%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	280,041	349,924	286,107	102.17%	81.76%	Jo e R
	Totali	€	2,694,414	3,519,651	3,031,528	112.51%	86.13%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,536,005	2,417,741	1,723,271	112.19%	71.28%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	181,106	315,084	166,207	91.77%	52.75%	Jo e R
	Totali	€	1,717,111	2,732,826	1,889,478	110.04%	69.14%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	995,872	1,715,042	949,714	95.37%	55.38%	Jo e R
	Subvencionet	€	694,153	403,077	366,612	52.81%	90.95%	Jo e R
	Ujërat e zeza	€	169,465	417,640	194,451	114.74%	46.56%	Jo e R
	Totali²	€	1,165,337	2,132,681	1,144,165	98.18%	53.65%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	2,147,187	2,526,395	2,350,933	109.49%	93.05%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	235,411	343,538	293,023	124.47%	85.30%	Jo e R
	Totali	€	2,382,598	2,869,933	2,643,956	110.97%	92.13%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	656,602	1,104,283	780,930	118.93%	70.72%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	126,381	324,587	143,428	113.49%	44.19%	Jo e R
	Totali	€	782,983	1,428,870	924,357	118.06%	64.69%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	996,887	1,344,031	1,042,805	104.61%	77.59%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	184,890	292,553	199,619	107.97%	68.23%	Jo e R
	Totali	€	1,181,777	1,636,583	1,242,424	105.13%	75.92%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	17,321,676	24,436,607	18,282,567	105.55%	74.64%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	1,993,600	3,150,001	2,132,167	106.95%	67.69%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	19,315,276	26,586,607	20,414,734	105.69%	76.79%	Jo e R

Për sektorin e ujit në Kosovë, sipas vlerësimeve të ZRRUK të vitit 2013, 89.56% e arkëtimit rrjedh nga shërbimi i ujit, ndërsa pjesa tjetër prej 10.44% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total për sektorin, gjatë vitit 2013 është realizuar arkëtimi në vlerë prej 20,414,734 €, e që paraqet 76.79 % të shumës së aprovuar gjatë procesit tarifor për vitin 2013.



² Subvencionet e dhëna nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbuluar kostot e ujit të trajtuar me shumicë për pjesën veriore të Qytetit të Mitrovicës, nuk përbëjnë totalin në këtë pikë, por ato janë vendosur vetëm si shifër ilustrative për të informuar palët e interesit.

7.4. Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza



Nga grafikoni merimangë vërehet se asnjëra nga KRU-të nuk ka arritur të realizoj arkëtimin ashtu siç është aprovuar nga ZRRUK në procesin tarifor 2012-2014, për vitin 2013.

Të hyrat nga subvencionet për mbulim të shpenzimeve operative në KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë për periudhën e shikuar janë 366,612 €, dhe kjo shtesë është paraqitur në përqindje me ngjyrë kafe në grafikon.

8. INVESTIMET KAPITALE

Me aprovimin e tarifave të reja për periudhën afatmesme 2012-2014, ZRRUK ka paraparë që të ndërmerren investime kapitale të konsiderueshme prej të gjitha kompanive të ujësjellësit, këto investime janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit, të cilat nëse realizohen do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë.

Sipas UKRR-s, investimet kapitale janë klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit dhe shërbimet e kanalizimit**, të cilat klasifikohen më tej:

I. Investimet në shërbimet e ujësjellësit më pastaj janë ndarë në:

- Investime në resurse dhe trajtim të ujit,
- Investime në distribuim, dhe
- Investime në aktivitete biznesore.

II. Kurse investimet në shërbimet e ujërave të zeza janë ndarë në:

- Investime në grumbullimin e ujërave të zeza,
- Investime në trajtimin ujërave të zeza,
- Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit, dhe
- Investime në aktivitete biznesore

Më pastaj, investimet në asetet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë ndarë në: **asete të infrastrukturës dhe ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** më tutje janë të ndara në investime: *(i)* të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës, *(ii)* dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asete nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha investimet në asetet mbitokësore siç janë: *(i)* fabrikat për trajtimin e ujit, *(ii)* ndërtesat administrative, *(iii)* mjetet transportuese, *(iv)* pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve më pastaj kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturës.

Për t'u njoftuar më në detaje për këto kategorizime mund të gjenden shpjegime në UKRR të cilat janë të publikuara në webfaqen zyrtare të ZRRUK.

8.1. Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake

Në tabelën e më poshtme paraqiten shumat e investimeve kapitale me financim nga burimet vetanake të kompanive për kategorinë e shërbimeve të ujësjellësit. Më këtë bëhet krahasimi i shumave të investimeve kapitale të aprovuara nga ZRRUK me ato të realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2013, % e realizimit të investimeve të planifikuara dhe vlerësimin tonë përfundimtar.

Tabela Nr. 6. Shumat e investimeve kapitale për ujë të financuar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara ma lartë në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 2013	Realizuara 2013	% e real. të cakt. 2013	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	6,005,401	948,438	15.79%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	1,352,662	216,827	16.03%	Jo e R
Distribuem	4,185,995	530,139	12.66%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	466,744	201,472	43.17%	Jo e R
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	104,695	231,478	221.10%	T P
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	131,214	!	E pa K
Distribuem	104,695	68,948	65.86%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	31,317	!	Jo e R
3. HIDRODRINI	644,517	251,323	38.99%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribuem	641,533	199,467	31.09%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	2,984	51,856	1737.91%	T P
4. MITROVICA	0	0	!	E pa K
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribuem	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
5. RADONIQI	397,247	526,472	132.53%	T P
Resurse dhe trajtimi i ujit	10,470	92,387	882.44%	Jo e R
Distribuem	386,778	176,656	45.67%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	257,428	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	115,838	53,281	46.00%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	36,643	3,200	8.73%	Jo e R
Distribuem	79,195	32,609	41.18%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	17,472	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	189,238	31,041	16.40%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	31,409	8,862	28.22%	Jo e R
Distribuem	157,829	6,638	4.21%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	15,541	!	E pa K
TOTALI	7,456,936	2,042,033	27.38%	Jo e R




Tabela Nr. 7. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të zeza te financuar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara ma lartë në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 2013	Realizuara 2013	% e real. të caktut 2013	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	491,538	1,184	0.24%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	372,407	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	104,695	0	0.00%	Jo e R
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	14,435	1,184	8.20%	Jo e R
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	123,460	316	0.26%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	123,460	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	316	!	E pa K
3. HIDRODRINI	157,200	2,729	1.74%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	157,043	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	157	2,729	1737.90%	T P
4. MITROVICA	142,490	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	142,490	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
5. RADONIQI	152,960	13,549	8.86%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	152,960	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	13,549	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	207,698	4,928	2.37%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	207,698	3,200	1.54%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	1,728	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	118,435	1,170	0.99%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	118,435	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	1,170	!	E pa K
TOTALI	1,393,782	23,876	1.71%	Jo e R

Tabela Nr. 8. Shumat e Investimeve kapitale të financuara nga burimet vetanke të kompanive për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në €

Emri i kompanisë	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 2012	Aprovuara nga ZRRUK 2013	Realizuar nga KRU 2013	% krahasuese 2013/2012	% e real. të caktut 2013	Vlerësimi përfundimtar 2013
Prishtina	Ujë	€	1,624,579	6,005,401	948,438	58.38%	15.79%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	25,549	491,538	1,184	4.63%	0.24%	Jo e R
	Totali	€	1,650,128	6,496,939	949,622	57.55%	14.62%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	363,346	104,695	231,478	63.71%	221.10%	T P
	Ujëra të zeza	€	10,839	123,460	316	2.92%	0.26%	Jo e R
	Totali	€	374,185	228,155	231,795	61.95%	101.60%	T P
Hidrodriini (PE)	Ujë	€	377,958	644,517	251,323	66.49%	38.99%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	157,200	2,729	!	1.74%	Jo e R
	Totali	€	377,958	801,717	254,052	67.22%	31.69%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	0	0	0	!	!	E pa K
	Ujëra të zeza	€	0	142,490	0	!	0.00%	Jo e R
	Totali	€	0	142,490	0	!	0.00%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	409,646	397,247	526,472	128.52%	132.53%	T P
	Ujëra të zeza	€	4,477	152,960	13,549	302.64%	8.86%	Jo e R
	Totali	€	414,123	550,207	540,021	130.40%	98.15%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	118,898	115,838	53,281	44.81%	46.00%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	7,421	207,698	4,928	66.41%	2.37%	Jo e R
	Totali	€	126,319	323,536	58,209	46.08%	17.99%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	82,252	189,238	31,041	37.74%	16.40%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	627	118,435	1,170	186.46%	0.99%	Jo e R
	Totali	€	82,879	307,673	32,211	38.86%	10.47%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	2,976,678	7,456,936	2,042,033	68.60%	27.38%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	48,913	1,393,782	23,876	48.81%	1.71%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	3,025,591	8,850,717	2,065,909	68.28%	23.34%	Jo e R

8.2. Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive



8.3. Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët

Në këtë tabelë paraqiten të dhënat e shumave të aprovuara dhe realizuara nga financimet e donatorëve të cilët kanë qenë pjesë të planifikimit të projekteve për realizim të investimeve kapitale për shërbimet e ujit gjatë vitit 2013. Krahasimi i këtyre të dhënave pasqyron shkallën e përbushjes së objektivave të përcaktuara për këtë periudhë kohore, të cilat epen në % me vlerësimin përfundimtarë.

Tabela Nr. 9. Shumat e investimeve kapitale për ujë të financiar nga donatorët sipas kategorive të theksuara më lartë në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 2013	Realizuara 2013	% e real. të caktut 2013	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	5,866,446	7,959,763	135.68%	T P
Resurse dhe trajtimi i ujit	464,847	1,314,892	282.87%	T P
Distribuim	5,401,599	6,624,489	122.64%	T P
Aktivitetet biznesore	0	20,383	!	E pa K
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	402,547	1,314,277	326.49%	T P
Resurse dhe trajtimi i ujit	329,261	688,969	209.25%	T P
Distribuim	73,287	527,929	720.36%	T P
Aktivitetet biznesore	0	97,379	!	E pa K
3. HIDRODRINI	1,580,898	643,625	40.71%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	732,867	182,739	24.93%	Jo e R
Distribuim	848,031	460,886	54.35%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
4. MITROVICA	9,778,534	2,047,019	20.93%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	9,422,570	0	0.00%	Jo e R
Distribuim	355,964	1,967,316	552.67%	T P
Aktivitetet biznesore	0	79,703	!	E pa K
5. RADONIQI	157,043	802,798	511.20%	T P
Resurse dhe trajtimi i ujit	157,043	517,231	329.36%	T P
Distribuim	0	285,177	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	391	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	633,134	0	0.00%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	Jo e R
Distribuim	633,134	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	0	0	!	E pa K
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
Distribuim	0	0	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
TOTALI	18,418,602	12,767,483	69.32%	Jo e R




Tabela Nr. 10. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të zeza të financuara nga donatorët sipas kategorive të theksuara ma lartë në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 2013	Realizuara 2013	% e real. të cakt. 2013	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	541,274	79,635	14.71%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	488,927	79,005	16.16%	Jo e R
Trajtim i u.z	52,348	0	0.00%	Jo e R
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	630	!	E pa K
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	933,881	12	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	933,881	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	12	!	E pa K
3. HIDRODRINI	2,669,728	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	2,093,904	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	575,824	0	0.00%	Jo e R
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
4. MITROVICA	0	5,087	!	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	5,087	!	E pa K
5. RADONIQI	0	21	!	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	21	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	0	0	!	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	0	0	!	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
TOTALI	4,144,884	84,756	2.04%	Jo e R

Tabela Nr. 11. Shumat e investimeve kapitale të aprovuar dhe realizuar nga donatorët për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza gjatë vitit 2013

Emri i kompanisë	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 2012	Aprovuara nga ZRRUK 2013	Realizuar nga KRU 2013	% krahasues 2013/2012	% e real. të caktut 2013	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	4,166,04	5,866,446	7,959,763	191.06%	135.68%	T P
	Ujëra të zeza	€	0	541,274	12	!	0.00%	Jo e R
	Totali	€	4,166,04	6,407,720	7,959,775	191.06%	124.22%	T P
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	3,074,31	402,547	1,314,277	42.75%	326.49%	T P
	Ujëra të zeza	€	46,471	933,881	12	0.03%	0.00%	Jo e R
	Totali	€	3,120,78	1,336,429	1,314,289	42.11%	98.34%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	3,244,59	1,580,898	643,625	19.84%	40.71%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	1,387,65	2,669,728	0	0.00%	0.00%	Jo e R
	Totali	€	4,632,24	4,250,626	643,625	13.89%	15.14%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	20,184	9,778,534	2,047,019	10141.6	20.93%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	1,288	0	5,087	394.88%	!	E pa K
	Totali	€	21,473	9,778,534	2,052,107	9556.83	20.99%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	275,412	157,043	802,798	291.49%	511.20%	T P
	Ujëra të zeza	€	2,345	0	21	0.90%	!	E pa K
	Totali	€	277,757	157,043	802,819	289.04%	511.21%	T P
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	637,283	633,134	0	0.00%	0.00%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	0	21	!	!	E pa K
	Totali	€	637,283	633,134	21	0.00%	0.00%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	1,288,76	0	0	0.00%	!	E pa K
	Ujëra të zeza	€	26,275	0	0	0.00%	!	E pa K
	Totali	€	1,315,04	0	0	0.00%	!	E pa K
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	12,706,5	18,418,602	12,767,483	100.48%	69.32%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	1,464,03	4,144,884	5,153	0.35%	0.12%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	14,170,6	22,563,486	12,772,636	90.13%	56.61%	Jo e R

8.4. Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët




8.5. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës

Është e njohur nga praktika e gjertanishme se të gjitha asetet kanë një jetëgjatësi të caktuar, prandaj për to alokohet pjesa përkatëse e mjeteve financiare (në rastin tonë asetet jo-infrastrukturore) në mënyrë që në fund të jetëgjatësisë së tyre tu zgajtet vlera e përdorimit të tyre ose të blihen asete të reja dhe të zëvendësohen me ato të vjetrat. Karakteristikë e kontabilitetit rregullator është se asetet të cilat gjenden nën nivelin e tokës (asetet infrastrukturore) nuk amortizohen, por u njihet shpenzimi për përtëritjen e infrastrukturës në shumën e aprovuar me procesin rregullator. ZRRUK ka konstatuar se kjo kategori e investime ka ndikim direkt në nivelin e shërbimeve.

Shuma e duhur e mjeteve financiare të nevojshme për përtëritje efektive infrastrukturore është vështirë të përcaktohet, por pas një periudhe të arsyeshme kohore dhe me të dhëna të mjaftueshme për shpenzime dhe për performancë është e mundur që të ndërlidhet shkalla e shpenzimeve me përmirësimin apo përkeqësimin e shërbyeshmërisë së infrastrukturës.

Në mungesë të të dhënave të besueshme për performancën e menaxhimit të aseteve në shqyrtimin tarifor 2012-2014, shumën e mjeteve fillestare të planifikuara për investime në përtëritjen e infrastrukturës është përcaktuar si një shpenzim vjetor prej të paktën 10% të vlerës së BRA për shërbimet e furnizimit me ujë dhe 10% të vlerës së BRA të sistemit për shërbimet e ujërave të zeza. Për procesin rregullator të tarifave 2012-2014 pas akordimit të arritur për të siguruar një nivel më të mirë të shërbimeve dhe ngritje minimale të tarifave reale është vendosur që tarifat e shërbimeve të ujit të ngritën mesatarisht për 4% me kosto shtesë të BRRA të ujit dhe ato të shërbimeve të ujërave të zeza me 10%. Ky proces është i ilustruar në figurën mëposhtme.



Sipas këtij procesi, për të gjitha KRU-të janë bërë rregullimet e nevojshme për të pasqyruar shumat e përtëritjes së infrastrukturës, siç edhe do të paraqiten në tabelat në vijim për vitin 2013.

Tabela Nr. 12. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për ujë

Emri i Kompanisë	Planifikuara nga KRU 2013		Aprovuara nga ZRRUK 2013		Realizuara nga KRU 2013		Vlerësimi përfundimtar	
	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion
PRISHTINA	2,278,168	3,762,746	3,348,433	3,762,746	267,342	0	Jo e R	Jo e R
HIDROREGJIONI JUGOR	0	0	0	0	50,119	97,656	E pa K	E pa K
HIDRODRINI	0	314,086	222,752	314,086	0	0	Jo e R	Jo e R
MITROVICA	0	0	0	0	0	1,953,124	E pa K	E pa K
RADONIQI	10,470	157,043	397,247	157,043	29,713	13,769	Jo e R	Jo e R
BIFURKACIONI	15,704	423,743	91,758	423,743	23,249	0	Jo e R	Jo e R
HIDROMORAVA	0	0	157,829	0	0	0	Jo e R	E pa K
TOTALI	2,304,342	4,657,618	4,218,019	4,657,618	370,423	2,064,549	Jo e R	Jo e R

Tabela Nr. 13. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për ujëra të zeza

Emri i Kompanisë	Planifikuara nga KRU 2013		Aprovuara nga ZRRUK 2013		Realizuara nga KRU 2013		Vlerësimi përfundimtar	
	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion
PRISHTINA	23,033	488,927	372,407	488,927	0	0	Jo e R	Jo e R
HIDROREGJIONI JUGOR	104,695	0	123,460	0	0	0	Jo e R	E pa K
HIDRODRINI	157,043	2,669,728	157,043	2,669,728	0	0	Jo e R	Jo e R
MITROVICA	0	0	142,490	0	0	0	Jo e R	E pa K
RADONIQI	10,470	0	152,960	0	0	0	Jo e R	E pa K
BIFURKACIONI	1,570	0	205,604	0	3,200	0	Jo e R	E pa K
HIDROMORAVA	0	0	118,435	0	0	0	Jo e R	E pa K
TOTALI	296,811	3,158,655	1,272,400	3,158,655	3,200	0	Jo e R	Jo e R

Tabela Nr.14. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Emri i Kompanisë	Planifikuara nga KRU 2013		Aprovuara nga ZRRUK 2013		Realizuara nga KRU 2013		Vlerësimi përfundimtar	
	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion
PRISHTINA	2,301,201	4,251,673	3,720,841	4,251,673	267,342	0	Jo e R	Jo e R
HIDROREGJIONI JUGOR	104,695	0	123,460	0	50,119	97,656	Jo e R	E pa K
HIDRODRINI	157,043	2,983,814	379,795	2,983,814	0	0	Jo e R	Jo e R
MITROVICA	0	0	142,490	0	0	1,953,124	Jo e R	E pa K
RADONIQI	20,939	157,043	550,207	157,043	29,713	13,769	Jo e R	Jo e R
BIFURKACIONI	17,275	423,743	297,362	423,743	26,449	0	Jo e R	Jo e R
HIDROMORAVA	0	0	276,264	0	0	0	Jo e R	E pa K
TOTALI	2,601,153	7,816,273	5,490,420	7,816,273	373,623	2,064,549	Jo e R	Jo e R

9. KONKLuzionet e Raportit

Nga ajo që u theksua ma lartë, duhet theksuar se qëllimi i këtij raporti është të sensibilizoj të gjithë akterët në sektorin e ujit për ecurinë e përmbushjes /mos përmbushjes së caqeve të përcaktuara në procesin tarifor të vitit 2013. Siç dihet, objektivat e përcaktuara nga ZRRUK me KRU-të, paraqesin “Marrëveshje Kontraktuale” për të cilat KRU-të janë të obliguara të punojnë në përmbushjen e tyre pasi që të njëjtat kanë ngarkuar tarifat e aplikuara. Konkluzionet e këtij raporti përshkruajnë të dhënat sektoriale me ndonjë specifikë për KRU-të.

Te dhënat operative

Sa i përket të dhënave operative në baza sektoriale nga katër indikatorët që janë marrë në shqyrtim dy prej tyre janë vlerësuar pozitivisht dhe dy negativisht. Sasia e ujit të prodhuar është vlerësuar negativisht ngase sasia e prodhuar është më e vogël se sasia e aprovuar nga ZRRUK. Edhe sasia e ujit të faturuar është nën vlerat e aprovuara dhe është vlerësuar negativisht derisa sasia e ujit të humbur është më e vogël nga sasia e pranuar nga rregullatori dhe për këtë vlerësimi është pozitiv sikur edhe për numrin e konsumatorëve ku kemi tejkallim në krahasim me parashikimet me biznes planet rregullatore.

Shpenzimet operative

Përpos KRU “Hidrodrini” që është përpjekur të mbajë në kontroll shpenzimet operative për këtë periudhë kohore, të gjitha KRU-të tjera kanë shpenzuar më shumë sesa u është aprovuar nga Rregullatori dhe që të gjitha janë vlerësuar “TN” (tejkaluar negativisht).

Faturimi në vlerë monetare

As një nga kompanitë nuk ka arrit të realizojë shumën e faturimit të aprovuar për periudhën e shikuar kohore edhe pse për nga angazhimi i tyre dallohen nga të tjerat KRU “Radoniqi” sh. a. Gjakovë dhe KRU “Hidroregjioni-Jugor” sh. a. Prizren. As një nga kompanitë nuk realizuar shumën e akorduar të faturimit, prandaj janë vlerësuar si “Jo e R” (jo e realizuar).

Arkëtimi në vlerë monetare

Të gjitha KRU-të që operojnë në Kosovë, janë larg realizimit të shkallës së arkëtimit krahasuar me atë që është aprovuar nga Rregullatori për këtë periudhë kohore. Mund të themi se më të angazhuarit në këtë drejtim kanë qenë; KRU “Radoniqi” sh. a. Gjakovë dhe KRU “Hidroregjioni-Jugor” sh. a. Prizren. Të gjitha KRU-të duhet të angazhohen më shumë në përmirësimin e shkallës së arkëtimit. As një nga kompanitë nuk realizuar shumën e akorduar të faturimit, prandaj janë vlerësuar si “Jo e R” (jo e realizuar).

Investimet Kapitale

Çështja e Investimeve Kapitale vazhdon të mbetet njëra ndër pikat më të dobëta për t’u realizuar nga KRU-të në Kosovë. Vetëm KRU “Hidroregjioni-Jugor” sh. a. Prizren dhe KRU “Radoniqi” sh.a –Gjakovë kanë arritur të realizojnë investime prej burimeve vetanake. Ndërkaq, të gjitha KRU-të tjera janë në një pozitë shumë të dobët të realizimit të investimeve prej burimeve vetanake. Rekomandohen KRU-të që të menaxhojnë në mënyrë efikase dhe të realizojnë investimet të cilat Rregullatori i ka aprovuar gjatë procesit rregullator.

Te dhënat e raportit dëshmojnë se edhe pse kemi ndonjë tregues pozitivë, kompanitë dhe sektori janë akoma larg përmbushjes së objektivave të përcaktuara për të cilat duhen angazhime shtesë të menaxhmenteve të tyre, të cilat edhe në vijim do të monitorohen.

10. RANGIMI I KRU-VE SIPAS REALIZIMIT TË CAQEVE

Nga raporti i përmbushjes së caqeve të cilin e punon DFTRR/ZRRUK vërehet se për secilën KRU është caktuar një cak përkatës përmes së cilit monitorohet shkalla e përmbushjes së tyre. Në këtë raport janë paraqitur një mori të dhënash të përcaktuara si cak, dhe secila prej tyre e ka rëndësinë e vet e cila mundëson KRU-se të ofrojë shërbime me nivel të kënaqshëm të ujësjellësit dhe grumbullimit të ujërave të zeza. Mirëpo nëse duam të kemi një pasqyrë të përgjithshme se cila prej KRU-ve ka arritur më së miri t’u afrohet përmbushjes së caqeve në krahasim me KRU-të tjera, DFTRR/ZRRUK do të paraqes një metodologji të rangimit të cilën e konsideron si më të arsyeshmen në rrethanat të cila gjenet sektori i ujit në Kosovë.

Kjo metodologji e rangimit të KRU-ve konsiston në të dhënat e paraqitura në raportin e përmbushjes së caqeve, ku për kategori të të dhënave është përcaktuar edhe pesha e tyre për vlerësim. Të dhënat janë ndarë në grupe dhe secili grup ka peshën e vet. Po ashtu edhe të dhënat brenda grupit kanë peshën e tyre përkatëse. Kjo metodologji më së miri mund të ilustruhet edhe përmes tabelës sqaruese në vijim.


Tabela Nr. 15. Metodologjia e rangimit të KRU-ve

Grupi i të dhënave	Komponentet e matjes së performances	Pesha komponentës	Pesha e grupit	Ndikimi individual
Të dhënat teknike	Prodhimi i Ujit	35%	25%	8.75%
	Humbjet e Ujit	25%		6.25%
	Faturimi i ujit (m3)	25%		6.25%
	Nr i konsumatoreve	15%		3.75%
Te dhenat financiare	Shpenzimet operative per uje	20%	45%	9.00%
	Shpenzimet operative U.Z	10%		4.5%
	Faturimi per uje (€)	20%		9.00%
	Faturimi per U.Z (€)	15%		6.75%
	Arketimi per uje (€)	20%		9.00%
	Arketimi per U.Z (€)	15%		6.75%
Investimet vetanake	Investimet vetanake për ujë	70%	30%	21.00%
	Investimet vetanake për U.Z	30%		9.00%
Performanca e pergjithshme			100%	100%

Një kompani ideale do duhej që në të gjithë këto caqe të matura t’u afrohej përmbushjes së tyre afër vlerës 100%. Kuptohet se ZRRUK gjatë gjithë proceseve tarifore u ka kushtuar rëndësi të veçantë aspektit të realizimit të investimeve prej burimeve vetanake të kompanive, ngase ato kanë ndikim në lartësinë e tarifës sikundër edhe në përmirësimin e nivelit të shërbimeve. Për këtë, sipas tabelës së mësipërme mund të vërehet se peshën më të madhe e ka kategoria e të dhënave “Investimet vetanake për ujë” dhe roli i kësaj kategorie në performancën e përgjithshme të kompanisë është 21% ($70\% \times 30\% = 21\%$). Në këtë mënyrë për të gjithë të dhënat tjera mund të

përfitohet ndikimi individual i secilës të dhënë në performancën e përgjithshme duke fituar kështu totalin prej 100%.

Grafikisht kjo metodologji më së miri do të paraqitet përmes diagramit vijues, i cili njëkohësisht paraqet të gjitha të dhënat e përcaktuara si cak nga DFTRR/ZRRUK, së bashku me peshën e tyre përkatëse. Kjo nënkupton se një kompani do duhej që sa më shume të jetë e mundshme të arrijë të mbush hapësirën përbrenda kësaj zone të caqeve. Prandaj dhe mund të themi se kompania e cila ka arritur të ketë sipërfaqe më të madhe brenda zonës së caqeve, do të jetë njëra ndër kompanitë që ka performuar më së miri gjatë vitit të caktuar.



Ndërkaq, të gjitha kalkulimet për secilën kompani paraqiten në tabelën vijuese me të dhënat se sa është përqindja e realizimit të caqeve si dhe ndikimi i tyre sipas peshës së asaj të dhëne.

Nëse themi se një kompani në cakun e prodhimit të ujit ka arritur të realizoj për 92.76 %, atëherë sipas metodologjisë kalkulimet do ishin si në vijim:

$$92.76\% \times 35\% \times 25\% = 6.493\%$$

Dhe në këtë mënyrë për të gjitha të dhënat tjera bëhet analiza e përmbushjes së caqeve sipas peshës së komponentës përkatëse duke fituar në fund një vlerësim të përgjithshëm në realizimin e caqeve të përcaktuara nga ZRRUK.





Tabela Nr.16. Kalkulimet e performancës së përgjithme të KRU-ve sipas peshës së të dhënave.

Komponenta	PR		PZ		PE		MIT		GJA		FE		GJI	
	% e cakt.	pesha e komp.	% e cakt.	pesha e komp.	% e cakt.	pesha e komp.	% e cakt.	pesha e komp.	% e cakt.	pesha e komp.	% e cakt.	pesha e komp.	% e cakt.	pesha e komp.
Prodhimi i Ujit	92.76%	8.117%	94.63%	8.28%	99.14%	8.68%	90.61%	7.93%	72.05%	6.30%	94.57%	8.27%	106.95%	8.75%
Humbjet e Ujit	106.43%	5.848%	92.03%	6.25%	104.32%	5.98%	94.04%	6.25%	54.43%	6.25%	112.71%	5.46%	112.71%	5.46%
Faturimi i ujit	82.03%	5.127%	98.79%	6.17%	88.11%	5.51%	87.45%	5.47%	109.59%	6.25%	78.86%	4.93%	100.55%	6.25%
Nr i konsumatorëve	95.40%	3.578%	113.88%	3.75%	115.27%	3.75%	98.99%	3.71%	99.33%	3.73%	90.85%	3.41%	116.89%	3.75%
Shpenzimet operative për ujë	139.55%	5.44%	117.95%	7.38%	101.29%	8.88%	113.03%	7.83%	136.20%	5.74%	107.17%	8.35%	119.56%	7.24%
Shpenzimet operative U.Z	125.81%	3.34%	106.75%	4.20%	102.65%	4.38%	114.46%	3.85%	208.53%	0.00%	157.89%	1.89%	128.47%	3.22%
Faturimi për ujë	77.65%	6.989%	89.91%	8.09%	80.62%	7.26%	76.50%	6.88%	96.70%	8.70%	82.35%	7.41%	88.67%	7.98%
Faturimi për U.Z	78.74%	5.315%	85.44%	5.77%	61.75%	4.17%	69.62%	4.70%	89.25%	6.02%	52.21%	3.52%	78.78%	5.32%
Arketimi për ujë	77.87%	7.008%	86.61%	7.79%	71.28%	6.41%	55.38%	4.98%	93.05%	8.37%	70.72%	6.36%	77.59%	6.98%
Arketimi për U.Z	76.75%	5.180%	81.76%	5.52%	52.75%	3.56%	46.56%	3.14%	85.30%	5.76%	44.19%	2.98%	68.23%	4.61%
Investimet vetanake për ujë	15.79%	3.32%	221.10%	21.00%	38.99%	8.19%	0.00%	0.00%	132.53%	21.00%	46.00%	9.66%	16.40%	3.44%
Investimet vetanake për U.Z	0.24%	0.02%	0.26%	0.02%	1.74%	0.16%	0.00%	0.00%	8.86%	0.80%	2.37%	0.21%	0.99%	0.09%
Vlerësimi i përgjithshëm	55.30%		92.56%		63.53%		49.94%		87.63%		61.71%		58.21%	

Tabela Nr. 17. Rangimi i KRU-ve për performancën më të mirë të realizimi të caqeve gjatë vitit 2013


Nr	Emri i kompanisë	Përqindja totale realizimit të caqeve
1	KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN	84.23 %
2	KRU "RADONIQI" SH.A - GJAKOVË	78.93 %
3	KRU "HIDRODRINI" SH.A - PEJË	66.92 %
4	KRU "HIDROMORAVA" SH.A - GJILAN	63.08 %
5	KRU "BIFURKACIONI" SH.A – FERIZAJ	62.47 %
6	KRU "PRISHTINA" SH.A - PRISHTINË	59.28 %
7	KRU "MITROVICA" SH.A - MITROVICË	54.74 %

Prej dhënave të fituara nga tabela e mësipërme tashmë mund të prodhojmë diagramet individuale për secilen KRU, ku mund të shihet edhe grafikish se cila prej tyre ka arritur më së shumti të mbush zonën me ngjyrë të verdhë, të cilën DFTRR/ZRRUK e konsideron si zonë e një kompanie ideale në rast të përmbushjes së caqeve.




RADONIQI

■ Kompania ideale
■ % e caqeve sipas peshës




BIFURKACIONI

■ Kompania ideale
■ % e caqeve sipas peshës



HIDROMORAVA

■ Kompania ideale
■ % e caqeve sipas peshës



Koeficientet e veçantë të dala në pasqyrën e Tabelës nr. 17. Rangimi i KRU-ve sipas shkallës së përfomancës së arritur gjatë vitit 2013 mund të përdoren për të vlerësuar rishikimin e tarifave të fillim vitit tjetër. Kjo sidomos vlen për treguesin e shkallës së realizimit të investimeve të aprovuara nga DFTRR,ZRRUK me financim të vet kompanisë.

Komentet e Menaxhmentit të KUR “Prishtina” sh.a. në Raportin Vjetor mbi vlerësimin e përmbushjes së caqeve të përcaktuara për vitin 2013 me procesin rregullator të tarifave 2012-2014

Komenti në pikën 5. Analiza e prodhimit, faturimit dhe konsumatorët

Tabela nr. 1. Pasqyra e të dhënave sasiore për ujin e prodhuar, humbjet, faturimi dhe nr. i konsumatorëve.

Plani i prodhimit aprovuar nga ZRRUK 44,465,000m³, pajtohem me këtë sasi të prodhimit të aprovuar nga Zyra e Rrregullatorit, për këtë edhe kemi patur konsultime të cilat kanë rezultuar me këtë sasi max. të prodhimit.

ZRRUK është dashtë të merr parasyshtë thatësinë që ka dominuar në 6 mujorin e dytë të vitit 2013 dhe të reduktoj planin e prodhimit për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme dhe detyrimit që ka rrjedh për të zvogluar prodhimin.

Duke korigjuar apo permirsuar planin e prodhimit që vitin 2012 ishte 48 milion metra kub në 44,465,000m³ logjikisht dhe domosdoshmërisht është dashtë të zvoglohet edhe sasia e ujit të faturuar, sasi kjo që ka ngelur e njetë si atëherë kur planifikohej të prodhoheshin 48 milion metra kub.

Uji i humbur aprovuar nga ZRRUK është 44% kundrejt faturimit në 56%, këto përqindje janë shumë të dëshiruara nga ne por sa i perket vitit 2013 thuajse kjo ishte e pamundur, nga njëra anë zvoglim i prodhimit gati për 10% ma pak se sa plani po ashtu edhe humbje uji apo uj pafaturuar deri në 50%. Kështu edhe ka qenë plani por kjo si duket nuk është pranuar nga Zyra rregullatore.

Ne mendojmë se faturimi aprovuar nga ZRRUK do të duhej të ishte 50% nga sasia e planifikuar për tu prodhuar, që do të thotë: Uji i humbur aprovuar nga ZRR: 22,232,500m³ po aq do të duhej të ishte edhe uji i faturuar. Ky veprim do të ishte krejt logjik kur do të merrnim për bazë sasinë e planifikuar të zvogluar të ujit të prodhuar, që do të duhej të zvoglohen edhe të gjithë treguesit tjerë.

Konsumatorët, shifra e aprovuar nga ZRRUK prej 105,418 është numri i konsumatorëve të regjistruar, dhe kjo në rastin tone thuajse paraqet një problem sepse një numer prej ma teper se

10,000 konsumator janë të regjistruar si konsumator fiktiv, mendojmë se ZRR është dashtë ta pranoj shifren e raportuar nga ne e që paraqet konsumatorët aktiv jo ata të pasivizuar.

Komentet e DFTRR-së

Tablela 1 – Uji i prodhuar, faturuar, humbjet dhe numri i konsumatorëve

Sasia e ujit të prodhuar është diskutuar në disa takime tona të përbashkëta dhe të njëjtën e kemi korrigjuar duke u ndërlidh me faktin se përfaqësuesit e kompanisë suaj gjatë procesit të kaluar rregullatorë nuk kanë identifikuar saktë përmbajtjen e celulës në fjalë dhe për këtë e kemi gjet të jete i arsyeshëm argumenti juaj i cili ndërlidhet me kapacitete të mundshme të prodhimit gjatë një viti. Ne jemi ne dijuni me gjendjen e thatësisë dhe vështirësitë e furnizimit me ujë që ka pasur kompania juaj. Pretendimet e uljes së mëtejme të sasisë së mundshme të ujit të prodhuar është dashur të iniciohen nga KRUP-ja, të cilën gjë KRUP-ja nuk e ka bërë.

- 1. Me rastin e korrigjimit të sasisë së ujit të planifikuar të prodhimit, ne nuk kemi bërë reduktime të kostove të operimit edhe pse kjo ka qenë rrjedha logjike e veprimeve nëse në një krahë ndërhyhet duhet vepruar edhe në krahun tjetër.*
- 2. Korrigjimi eventual i sasisë së ujit të furnizuar për shkak të thatësisë do të kishte për efekt të njëjtat veprime si në rastin e parë të zvogëlimit të sasisë së uji të prodhuar dhe kostove të operimit dhe me këtë rast outputet e prodhimit janë ma të vogla.*
- 3. Po të vepronim sipas pretendimeve të juaja do të duhej reduktuar edhe kostot e aprovuara për investim e kapitale.*

Si rezultat i asaj që u theksua ma lartë (pika 1-3) edhe tarifrat do të duhej ulur në proporcion me të dhënat e tilla të dala, kjo do të duhej të ishte rrjedha logjike zingjirore i uljes së: fondit të pagave, kostove të energjisë, kemikaljet etj . Këto veprime nuk janë bërë për shkak të logjikes së krijimit të kushteve për qëndrueshmërinë financiare të KRUP-ës.

Numri i konsumatorëve të aprovuara nga ZRRUK paraqet shifër të cilin kompania juaj e ka paraqitur si të tillë gjatë aplikimit të procesit tarifor 2012-2014, për vitin 2013, dhe udhëzimet tona në atë kohë kanë qenë që të futen vetëm konsumatorë aktiv, dhe jo ata pasiv (fiktiv). Kjo çështje për herë të parë po adresohet nga ju, pasi asnjëherë për këtë nuk është diskutuar.

Tabela nr. 2. Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për uj dhe ujëra të zeza

Pasqyra e shpenzimeve në kolonën historike tregon për këto shpenzime të cilat ishin 8,054,779€, është krejt normale që ky lloj i shpenzimeve të ketë një trend të vogël rritjeje dhe ashtu edhe ka ndodh, Realizimi nga KUR është 8,110,495€. Shiquar nga plani I KURP ne jemi mjaft mire në këtë pozicion, kurse Aprovimi nga ZRRUK për shpenzimet e Ujit dhe Kanalizimit është 5,832,212€. Dallim prej 2,200,000€, vlerë kjo shumë e lartë dhe që duhet diskutuar ZRRUK/KURP.

Komentet e DFTRR-ës

Tabela 2 – Shpenzimet operative

Shpenzimet operative të dorëzuara nga kompania juaj gjatë procesit tarifor 2012-2014 për vitin 2013 kanë qenë 6,562,494 €, por pas intervenimeve nga ZRRUK kjo shifër është reduktuar në 5,570,657 €. Arsye e veprimit të tillë kanë qenë kostot tuaja të larta në disa kosto qendra dhe atëherë është menduar se do të racionalizoni të njëjtat e jo ato t'i ngritni edhe më tej. Për të cilat kemi tërheq vërejtjen në çdo raport të vlerësimit tonë të përmbushjes së caqeve.

*Te ky grupim i zërave të vetmet ndërhyrje që janë bërë nga ana e jonë, kanë qenë përshtatja me lëvizjet inflatore të periudhës dhe vlera e fundit pas përshtatjes me inflacion për vitin 2013 është **5,832,212€**.*

Ky reduktim sipas kosto qendrave është bërë për të gjitha KRU-të në Kosovë, pa përjashtim, sipas qasjes shkencore të analizës se regresionit linear (shih Raportin tarifor 2012-2014 faqe 22), nga se ZRRUK ka konsideruar që shpenzimet operative janë më të larta dhe ka kërkuar që KRU-të të jenë sa më efektive.

Siç shihet, edhe nëse nuk do ishin bërë shkurtime nga ZRRUK, kompania juaj nuk ka bërë planifikime të bazuara mirë në vitin 2011 për vitin 2013, pasi nga 6.5 milion € që keni planifikuar keni tejkaluar të njëjtat për 1,537,506 € ose shprehur në % ky tejkalim arrin në 23.42% gjatë vitit të shikuar.

Kjo vetvetiu flet për aspektet e tjera të operimit, pa i shtuar ndonjë koment tonin tani për këtë, pas është e qartë se nuk ka qenë kujdesi i duhur për t'i mbajtur nën menaxhim të duhur kostot e operimit.

Tabela nr. 3 Shpenzimet e pagave në raport me shpenzimet totale he paga mesatare për vitin 2013.

Pajtohem se mesatarja e pages në KURP në krahasim me pagat në kompanitë tjera të llojit të njetë janë të larta, por duhet të cekim se edhe volume i punëve dhe angazhimet e stafit në KURP në krahasim me kompanitë tjera të llojit të nejtë në vend janë më të mëdha dhe më të komplikuar. Megjithëse mesatarja në KURP është më e larta në vend, nga pasqyra e juaj shihet se pjesmarrja e pagave në % në totalin e shpenzimeve është ma e ulëta në Kosovë. 53% e shpenzimeve për pagan ë tatal te shpenzimeve është KURP, që del të jetë perqindja më e ulët, deri sa Radoniqi arrin në 70% shpenzime per paga nga shpenzimet totale operative.

Komentet e DFTRR-ës

Tabela 3 - Shpenzimet e pagave

Shpenzimet e pagave paraqiten vetëm si të dhëna krahasuese me kompanitë tjera, për të parë se si qëndrojnë me këtë zë në raport me shpenzimet totale dhe me numër te punëtoreve. ZRRUK nuk ka bërë asnjë vlerësim për asnjërën kompani, shifrat flasin vet, dhe ju keni të drejte kur thoni se keni raportin më të vogël të % së pagave krahasuar me shpenzimet totale. Ne, mendojmë se propocioni i pagave të çdo njëra kompani është jo ekonomik, nëse shuma e tillë është gjysma ose mbi gjysmën e kostove të përgjithshme, diçka nuk është në rregull dhe me këtë mund të konstatojmë se operimi është jo optimal.

Tabela nr. 4 Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujra të zeza në vlerë monetare

Bazuar në treguesit tjerë që paraprijnë momentin deri te paraqitja tabelare nr. 4 del rezultati se Totali i faturimit monetary për uj dhe ujra të zeza aprovuar nga ZRRUK do të duhej të ishte 14,228,800€ e jo 16,116,589€ sa është aprovuar nga ZRRUK. Kjo do të duhej të ndodhte po që se nuk do të merrnim parasyshë se 4 milion metra kub uj kemi prodhuar ma pak duke qenë të shtyrë nga dominimi I thatësisë dhe mungesës së madhe të ujit në liqejtë akumulues dhe burimet nëntoksore të KURP. Mendojmë se ZRRUK duhet me reflektu dhe me konsideru gjendjen me të cilën jemi perballur në fund vitin e kaluar apo për periudhën që kemi marrë këtë raport.

Komentet e DFTRR-ës

Tabela 4 - Faturimi dhe arkëtimi në vlerë monetare

Ndërlidhet me shpjegimin e bërë në “tabelën 1”. Alternativë a asaj që ju keni theksuar, do të ishte zvogëlimi i humbjeve të ujit dhe gjetja e mundësive për t'i zvogëluar humbjet teknike dhe komerciale dhe fut në sistem të faturimit të gjithë, ose shumicën e konsumatorëve që marrin shërbime pa u legjitimuar si të tillë dhe mekanizmat për këtë mendojmë se ekzistojnë, vetëm kërkojnë implementimin e tyre.

Tabela nr. 5 Shumat e arkëtitimit për shërbimet e ujit dhe ujrave te zeza.

Po konsiderojmë se planifikimi i inkasimit msipas ZRRUK ka qenë 76% nga faturimi atëherë në këtë rast do të duhej të aprovohej nga ZRRUK plani i arkëtitimit prej: 10,813,888.00€ (Faturimi 14,228,800€ x 76% = 10,813,888€) jo 12,266,063€-ZRRUK.

Komentet e DFTRR-ës,

Tabela 5 – Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Ndërlidhet me shpjegimin e bërë në “tabelën 1”. Përshkrimet e komenteve tona të dhëna te pasqyra e të dhënave të Tabela 4., vlejné edhe në këtë rast, pasi duhet të mbështetemi në të njëjtat veprime dhe premisa për ta avancuar nivelin e shërbimeve.

Tabela nr. 6 Shumat e investimeve kapitale për ujë të financuara nga burimet vetanake

Deshtimi i fillimit të investimeve të fazes së dytë që një pjesë e këtij projekti financohet nga Kredia ka dështuar të filloj implementimi gjatë vitit 2013, kjo ka bërë që niveli i investimeve vetanake të dështoj apo të jetë vetëm 15.79%, kur jemi te ky pozicion ne jemi shumë të pakënaqur por duke pasëparasyshë se investimet e parapara për vitin 2013 janë duke u zhvilluar në vitin 2014, jemi të kënaqur dhe paralajmrohet një vit i permbushjes së caqeve të parapara me planin e biznesit. Një problem tjetër është edhe në mosperputhjen e Planit të biznesit të KURP me Planin e Rregullatorit të cilët gjatë Planifikimit kanë paraparë caqe shumë më optimiste dhe % të realizimit shumë më të larta se sa ne në KURP dhe nga kjo ka pasuar teprica e parave të cilat automatikisht janë destinuar për investime kapitale.

Komentet e DFTRR-ës

Tabela 6 - Investimet Kapitale

Ju përkujtojmë se gjatë procesit tarifar 2012-2014, për vitin 2013 kompania juaj ka planifikuar të ketë investime vetanake në vlerë prej 4,849,600 €, kësaj shume ne i kemi shtuar edhe shumën prej 1,355,973 € (Uje1,022,267€ + U.Z 333,706€) për të përcaktuar shumën e planifikuar të investimeve të pritshme prej 6,205,573 € gjatë vitit tani të përmbyllur 2013.

Vlera shtesë e investimeve të planifikuar 1,355,973 € i ishte dedikuar investimeve në përtëritjen e infrastrukturës, shumë kjo e cila paraqet 10% të BRRRA për ujë dhe 10% të BRRRA për Ujëra të zeza (shih Raportin Tarifar 2012-2014, faqe 11 dhe 12). Të gjitha këto janë bërë duke u bazuar në praktikën më të mira të rregullimit të sektorit të ujit në bashkërendim me konsulentët e fundit të projektit mbështetës në ZRRUK, për mbajtjen në nivel ose ngritjen e bazës dhe vlerës së aseteve.

Përveç vitit 2013, nga procesi i kaluar rregullatorë i tarifave ka kaluar edhe viti 2012 i cili nuk është identifikuar si shumë ma i mire se viti 2013.

Në kontekstin e investimeve që priten të realizohen gjatë vitit 2014 nga kompania juaj, shprehim konsideratën tonë nëse ato do arrijnë të përmbushin cakun e përcaktuar gjatë këtij viti. Kuptohet që për një angazhim të tillë, Ju vet dhe gjithë të tjerët do ju vlerësojnë angazhimin tuaj për përmbushje të caqeve të përcaktuara e që pa dyshim do të ketë ndikim pozitiv në performancën e përgjithshme të kompanisë nëse vërtet realizohet shuma e tilla.

Prishtinë, 22. 07. 2014

DFTRR, ZRRUK